



**VENDIM**

**Nr. 22 Datë 21.03.2014**

**PËR**

**KUALIFIKIMIN E IMPIANTIT PRODHUES TË SHOQËRISE “M.T.C ENERGY” SH.P.K NGA HEC “RADOVË”**

Në mbështetje të neneve 8 pika 2, gërma “l”, 9 dhe 39 të Ligjit Nr. 9072, datë 22.05.2003 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” të ndryshuar, nenit 3, pika 1, germa f, te ligjit 138/2013, date 02.02.2013 “Për Burimet e Energjisë së Rinovueshme“ nenit 9 pikat 1 dhe 2 gërma “a” të Rregullave dhe Procedurave të Çertifikimit të Prodhimit të Energjisë Elektrike nga Burimet e Rinovueshme të miratuara me Vendimin e Bordit të Komisionerëve Nr. 9, datë 21.02.2007, Bordi i Komisionerëve, në mbledhjen e tij të datës 21.03.2014, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “M.T.C Energy” sh.p.k për kualifikimin e impiantit prodhues për Hec “Radovë”, si burim i rinovueshëm energjie,

**Konstatoi se:**

Aplikimi i paraqitur nga shoqëria “M.T.C Energy” sh.p.k, është konform Rregullave dhe Procedurave të Çertifikimit të Prodhimit të Energjisë Elektrike nga Burimet e Rinovueshme si më poshtë:

- **Neni 7, pika 1, gërmat “a”, “b”, “c”, “d”**  
Përshkrimi i përgjithshëm i centralit.  
Ky dokumentacion është dhënë i sakte dhe i plote.
- **Neni 7, pika 2, gërmat “a”, “b”, “c”, “d”**  
Dokumentacioni vijues grafik, koreografia, planimetria e përgjithshme, skema funksionale etj.  
Ky dokumentacion është paraqitur ne mënyrë korrekte.
- **Neni 7 pika 3, gërmat “a”, “b”, “c”**  
Përshkrimi i centralit..  
Ky dokumentacion është dhënë i sakte dhe i plote.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s,

**Vendosi :**

1. Të kualifikojë impiantin prodhues të shoqërisë “M.T.C Energy” sh.p.k nga Hec “Radovë”, si burim i rinovueshëm energjie.
2. Ngarkohet Drejtoria e Liçensimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin lidhur me Vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.